

Njoftim Shtypi

Dt 5 Mars 2009

Qendra për Çështjet e Informimit Publik, ÇIP, konstaton shqetësimin e thellë me të cilin opinioni publik shqiptar po përcjell skandalin e rëndë seksual në të cilin është përfshirë ish ministri i kulturës Ylli Pango dhe falë tij edhe qeveria shqiptare. ÇIP përgëzon megjithatë reagimin e menjëhershëm të kryeministrit Berisha për shkarkimin këtij zyrtari që përfaqëson degjenerimin më të thellë moral të funksionarëve të lartë shtetërorë në këto 20 vitet e fundit.

Nga ana tjetër, ÇIP denon hezitimin Kuvendit për të reaguar me të njëjtën shpejtësi për heqjen e imunitetit të Pangos pas bërjes publike të skandalit nga FIKS FARE. Duke mos vepruar energjikisht në këtë drejtim, Kuvendi rrezikon të kthehet në protektor të Ylli Pangos, i cili duhet të ndiqet penalisht nga Organi Qëndror i Akuzës.

Sikurse u provua katërcipërisht nga gazetarët e “Fiks Fare”, Pango ka konsumuar elementë të veprës penale të tentativës për përdhunim dhe të shpërdorimit të detyrës.

ÇIP i kërkon Prokurorisë së Përgjithshme të veprojë energjikisht për të proceduar penalisht Ylli Pangon, duke iniciuar kërkesën zyrtare në adresë të Kuvendit për zhveshjen e tij nga imuniteti i deputetit.

Duke njohur natyrën hakmarrëse të Pangos, CPI kërkon nga organet përgjegjëse për sigurimin e jetës në Rep. e Shqipërisë marrjen nën mbrojtje të vajzave që u bënë protagoniste të demaskimit publik të sjelljes prej seksomani të ish ministrit dhe të abuzimit flagrant me postin e funksionarit të lartë publik prej tij.

ÇIP kërkon nga Akademia e Shkencave revokimin e menjëhershëm të titujve akademike të cilat i janë akorduar Pangos. Mos-revokimi i tyre përlyen gjithë profesoratin shqiptar pasi njollos vlerat dhe parimet më substanciale mbi të cilat ai mbështetet.

ÇIP gjithashtu kërkon reformim të menjëhershëm të sistemit aktual të rekrutimit të stafit në administratën publike. Pango provoi katërcipërisht atë që prej kohësh përflietj si një dështim I këtij sistemi që funksionon sa për sy e faqe. Pango nuk është I vetmi ministër që me veprimet e tij në rekrutimin e stafit ka njollosur rëndë rolin dhe funksionet e DAP, tashmë të kthyer në një instucion që prostituon me ministrat në kurris të qytetarëve të ndershëm shqiptarë që kërkojnë punë duke ndjekur të gjitha kriteret ligjore që ka shpallur në letra qeveria shqiptare.

CPI kërkon ndërmarrjen e një hetimi parlamentar për të verifikimin e dhjetëra ankesasve të depozituara për mungesë transparencë dhe hipokrizi në praktikat e ndjekura deri tani për rekrutim në administratën publike.

Falë kurajos qytetare të një vajze dhe falë kurajos gazetareske të FIKS FARE, shoqëria shqiptare merr sot frymë më e lehtësuar dhe kërkon ndëshkimin më të rëndë që parashikon ligji për njeriun i cili prej kohësh përflietj si seksoman dhe mitoman me rrezikshmëri të lartë shoqërore.